



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2076/6prot

Datë 21.10.2022

V E N D I M
Nr. 1032/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.10.2022 me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes lidhur me ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ASI-2A CO” SHPK & “Shendëlli” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-39373-08-19-2022, me objekt *“Rikonstruksioni i shkollës 9-vjecare “5 Dëshmorët + kopësht, Suk1, ambiente sportive dhe ndërtim i palestrës”* me fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 78 583 225 (shtatëdhjetë e tetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 07.09.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Roskovec.

Ankimues: BOE “ASI-2A CO” SHPK & “Shendëlli” SHPK
Adresa: Rruga Skënderbeu, Lagjja Bishanake, pallati nr. 18, hyrja nr. 6. Fier.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Roskovec
Bashkia Roskovec - Fier, Lagjja nr.1

Subjekt i interesuar: “Boshnjaku B” SHPK
Lagjja “Bishanake”, Rruga Skënderbeu, Nr. 8, pranë karburantit “Bolv – Oil”, Zona kadastrale nr. 8532, Fier

Baza Ligjore: Nenet 30, 115, 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit*

Publik". Nenit 4, te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19"

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 23.08.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit "Procedurë e hapur" me Nr. REF-39373-08-19-2022, me objekt "Rikonstruksioni i shkollës 9-vjecare "5 Dëshmorët + kopësht, Suk1, ambiente sportive dhe ndërtim i palestrës" me fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 78 583 225 (shtatëdhjetë e tetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.09.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Roskovec.

II.2. Në datën 07.09.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 20.09.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin e ofertave si vijon:

BOE "ASI-2A CO" SHPK & "Shendëlli" SHPK	67.282.494 lekë pa TVSH skualifikuar
Boshnjaku B SHPK	73.589.752 lekë pa TVSH kualifikuar
Jogi SHPK	75.147.508 lekë pa TVSH kualifikuar
Udha SHPK	76.802.082 lekë pa TVSH kualifikuar

II.4. Më datë 20.09.2022 autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike ka njoftuar bashkimin e operatorëve ekonomikë "ASI-2A CO" SHPK & "Shendëlli" SHPK

për vlerësimin e procedurës së prokurimit nga ku rezulton, se ky operator ekonomik është skualifikuar me arsytet si më poshtë vijojnë:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi skualifikimin e këtij Operatori Ekonomik pasi konstatoj në sistem se: 1. ASI- 2A CO nuk ka paraqitur deklaratë për shlyerje të detyrimeve për taksat vendore në vendin e ushtrimit të veprimtarisë. 2. Në DST në pikën 2.3.11 kërkohet që operatori Ekonomik të mos ketë detyrime për taksa , gjoba dhe debi të ndryshme, në këtë rast operatori Ekonomik SHENDELLI SHPK ka gjoba të pashlyera kundrejt bashkisë Roskovec. 3. Në DST është kërkuar 500 m2 betoforma, por nga të dy operatorët ekonomik është deklaruar për 500m dhe jo m2. 4. Në DST është kërkuar 40 stampa betoni, Nga BOE është paraqitur numri i faturës por pa përcaktuar sasinë. Operatori Ekonomik ASI- 2A CO nuk ka deklaruar në shtojcën 8, kontrata të tjera aktive, ndërsa në fakt rezulton të këtë kontrata aktive si më poshtë: - Bashkia Durrës , Kontratë e lidhur më datë 15.08.2022 , Afati i kontratës 32 ditë, Objekti i Kontratës: “Ndriçim Rruga Vllazërimi”, vlera pa TVSh 8’924’100 lekë dhe vlera me TVSh 10’708’920 LEKE - Spitali Rajonal Vlore, Kontratë e lidhur më datë 22.08.2022 , Afati i kontratës 90 ditë, Objekti i Kontratës“ Rikonstruksion i Farmacisë dhe i Dispanserisë për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë “ ,Vlora pa TVSh 32 980 561,63 dhe 39 066 613.95 lekë me TVSH

II.5. Në datën 21.09.2022, është publikuar njoftimi i fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik, prej të cilës rezulton fitues operatori ekonomik Boshnjaku B ShPK.

II.6. Në datën 26.09.2022 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2076/2022protokolli, datë 25.09.2022 dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2563 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ASI-2A CO” SHPK & “Shendëlli” SHPK. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ASI-2A CO” SHPK & “Shendëlli” SHPK.

Gjithashtu, pranë Komisionit të Prokurimit Publik bashkimi i operatorëve ekonomikë “ASI-2A CO” SHPK & “Shendëlli” SHPK ka paraqitur ankesën protokolluar me tonën nr. 2076/3prot datë 27.09.2022 me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur nëpërmjet sistemit të Ankesave Elektronike, ankesa me nr. 2076/2022protokolli, datë 25.09.2022 dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2563.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 2076/2 Prot., date 27.09.2022 duke referuar arsytet mbi skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.8. Me shkresën nr. 8699/2 prot., datë 05.10.2022, protokolluar me tonën me nr. 2076/5 prot., datë 10.10.2022, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni përkatës i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit lidhur me trajtimin e ankesës të bashkimit të operatorëve ekonomikë “ASI-2A CO” SHPK & “Shendëlli” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.9. Referuar informacionit të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit me shkresën nr. 8842/2prot datë 28.09.2022 me objekt: “Dërgohet vendimi nr. 8842/2 datë

28.09.2022 për shqyrtim e ankesës së operatorit ekonomik “ASI-2A CO” SHPK”, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik dhe operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë “Boshnjaku B” ShPK ka vendosur:

“[...] VENDOSI:

1.Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “ASI-2A“ SHPK për: procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i shkollës9-vjecare “5 Dëshmorët + kopsht, Suk 1, sportive dhe ndërtim i palestrës.”

2.Autoriteti kontraktor të shfuqizojë vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ASI-2A“ SHPK në procedurat e mësipërme të prokurimit.

3.Autoriteti kontraktor të anulojë të gjitha pasojat juridike të ardhura nga vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomikë “ASI-2A“ SHPK, në procedurat e mësipërme të prokurimit, si dhe të kalojë për rivlerësim të procedurave të mësipërme të prokurimit në SPE.

4.Ky vendim i vihet në dispozicion menjëherë Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Roskovec.

5.Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim ankuesit nga operatori ekonomikë “ASI-2A“ SHPK dhe Komisionit të Prokurimit Publik.[...]”

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se në datën 03.10.2022 (nr. 2076/4prot.), operatori ekonomik “Boshnjaku B” ShPK (formulari i paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë autoritetit kontraktor dhe komisionit të prokurimit publik), ka pasur pretendime në cilësinë e subjektit të interesuar, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi vendimet e KVO-së për skualifikimin e ofertës të paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1 Me shkresën nr. 8699/2 prot., datë 05.10.2022, protokolluar me tonën me nr. 2076/5 prot., datë 10.10.2022, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni përkatës i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit lidhur me trajtimin e ankesës të bashkimit të operatorëve ekonomikë “ASI-2A CO” SHPK & “Shendëlli” SHPK, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

Referuar informacionit të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit me shkresën nr. 8842/2prot datë 28.09.2022 me objekt: “Dërgohet vendimi nr. 8842/2 datë 28.09.2022 për shqyrtim e ankesës së operatorit ekonomik “ASI-2A CO” SHPK”, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik dhe operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë “Boshnjaku B” ShPK ka vendosur:

“[...] VENDOSI:

1 .Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “ASI-2A“ SHPK për: procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjecare “5 Dëshmorët +kopsht, Suk 1, sportive dhe ndërtim i palestrës.”

2.Autoriteti kontraktor të shfuqizojë vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorit ekonomik “ASI-2A“ SHPK në procedurat e mësipërme të prokurimit.

3.Autoriteti kontraktor të anulojë të gjitha pasojat juridike të ardhura nga vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorit ekonomikë “ASI-2A“ SHPK, në procedurat e mësipërme të prokurimit, si dhe të kalojë për rivlerësim të procedurave të mësipërme të prokurimit në SPE.

4.Ky vendim i vihet në dispozicion menjëherë Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Roskovec.

5.Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim ankuesit nga operatorit ekonomikë “ASI-2A“ SHPK dhe Komisionit të Prokurimit Publik.[...]

II.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 114 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se:

1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të

punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.5. Sa më sipër, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor Bashkia Roskovec e ka pranuar plotësisht ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ASI-2A CO” SHPK & “Shendëlli” SHPK ankimues për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi. Në këto kushte, bazuar në pikën 3 gërma “a” të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ASI-2A CO” SHPK & “Shendëlli” SHPK.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe

funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ASI-2A CO” SHPK & “Shendëlli” SHPK, për procedurën e prokurimit me “Procedurë e hapur” me Nr. REF-39373-08-19-2022, me objekt “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare “5 Dëshmorët + kopësht,Suk1, ambiente sportive dhe ndërtim i palestres” me fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 78 583 225 (shtatëdhjetë e tetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 07.09.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Roskovec.
 2. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ASI-2A CO” SHPK & “Shendëlli” SHPK.
 4. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

